

Specialist në Sektorin e Kontrollit, Drejtoria e Certifikimit Elektronik dhe Kontrollit, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike

Në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Aktit Normativ të miratuar nga Këshilli i Ministrave, Nr.15, Datë 13.10.2022, Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9880, Datë 25.02.2008, “Për Nënshkrimin elektronik”, të ndryshuar, VKM-së Nr.141, datë 22.02.2017 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike, Urdhërit nr. 6, datë 16.01.2020, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist në Sektorin e Kontrollit, Drejtoria e Certifikimit Elektronik dhe Kontrollit, në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

1. Përgatit kalendarin e auditit duke koordinuar punën me specialistët teknikë dhe përgjegjës të sektorit për auditet periodike të OKSHB dhe OIK dhe OIR;
2. Përgatit check listën për auditet dhe auditet e OKSHB dhe OIK dhe OIR duke koordinuar punën me specialistët teknikë dhe përgjegjës të sektorit;
3. Kontrollon dhe mbikëqyr Ofruesit e Kualifikuar të Shërbimit të Besuar (OKSHB) dhe OIK & OIR, në lidhje me implementimin e procedurave të sigurisë dhe besueshmërisë, konform legjislacionit të fushës;
4. Ndjek arritjen e zgjidhjeve ligjore për ankesat që i drejtohen Autoritetit në ushtrimin e aktivitetit të tij, deri në përfaqësimin para Gjykatës dhe raporton tek përgjegjësi i sektorit, për ecurinë e tyre;
5. Mban korespondencën me Ofruesit e shërbimit të besuar dhe operatorët e infrastrukturave të informacionit, me qëllim mbarëvajtjen e procesit të auditit;
6. Përgatit draft raportin e auditit të kryer pranë OKSHB, OIK dhe e koordinon atë me sektorin;
7. Siguron mbështetje nga ana procedurale kur i kërkohet, strukturave të Autoritetit;
8. Me miratimin e eprorit kryen detyra të veçanta në ndihmë të sektorëve të tjerë.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

- Të zotërojë diplomë të nivelit Master Profesional në Shkenca Juridike; Edhe diploma “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë;
- Të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- Të ketë të paktën 1 (një) vit eksperience pune;
- Njohuri shumë të mira mbi: Legjislacionin e sigurisë kibernetike. Specialitetet brenda fushës së caktuar profesionale;
- Të ketë aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale si dhe të identifikoj dhe qartësoj çështje epër të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale;
- Të ketë aftësi shumë të mira në analizimin dhe zgjidhjen e problemeve në kohë reale;
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikuese dhe të bashkëpunimit në grup;

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (III-b)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 29.11.2022, në adresën e e-mailit: burimet.njerezore@cesk.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmive të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.